



ПОТТИКНУВАЊЕ НА ГРАЃАНСКИОТ АКТИВИЗАМ
ЗА СЛЕДЕЊЕ И ИЗВЕСТУВАЊЕ НА НЕЗАКОНИТО
ПОСТАПУВАЊЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА



ИНСТИТУТ ЗА СТРАТЕШКИ ИСТРАЖУВАЊА И ЕДУКАЦИЈА
INSTITUTE FOR STRATEGIC RESEARCH AND EDUCATION

STUDIM THEMELOR

PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E DENONCUESVE, LIGJIT PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA ME KARAKTER PUBLIK DHE LIGJIT PËR VEPRIM NDAJ PARASHTRESAVE DHE PROPOZIMEVE NË NIVEL LOKAL NË REPULIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



U.S. Embassy Skopje

Овој проект е делумно поддржан од Амбасадата на САД.
Мислењата, откријата и заклучоците или препораните
изнесени овде се на имплементаторот, авторот(ите)
и не ги одразуваат оние на Владата на САД.

STUDIM THEMELOR

për implementimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik dhe Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut

STUDIM THEMELOR PËR IMPLEMENTIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E DENONCUESVE, LIGJIT PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA ME KARAKTER PUBLIK DHE LIGJIT PËR VEPRIM NDAJ PARASHITESAVE DHE PROPOZIMEVE NË NIVEL LOKAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT
Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim – IHSE

Për botuesin

Dr. Misho Dokmanoviq

Autor

Dr. Darko Spasevski

Lektor

Liljana Jovanovska

Shtypi

Stobi DOOEL – Skopje

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

35.077/.078:35.075]:340.13(497.7)

061.2:[35.077/.078:35.075(497.7)

СПАСЕВСКИ, ДАРКО

Основна студија за имплементацијата на Законот за заштита на укажувачите, Законот за слободен пристап до информации од јавен карактер и Законот за постапување по претставки и предлози на локално ниво во Република Северна Македонија / автор Дарко Спасевски. - Скопје: Институт за стратешки истражувања и едукација - ИСИЕ, 2020. - 50 стр. ; 25 см

Публикацијата е во рамки на проектот: "Поттикнување на граѓанскиот активизам за следење и известување на незаконито постапување на локалната самоуправа"

ISBN 978-608-66313-2-1

а) Државни органи - Контрола на постапки - Законска регулатива - Македонија б) Граѓански сектор - Незаконити постапки - Државни органи - Македонија
 COBISS.MK-ID 112267018



Проекти "Stimulimi i aktivizmit qytetar për monitorimin dhe raportimin e veprimeve të paligjshme të vetadministrimit lokal" është zbatuar nga Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim - IHSE në periudhën 2019-2020.

Ky projekt është i mbështetur pjesërisht nga Ambasada e SHBA-së. Mendimet, gjetjet dhe konkluzionet ose rekomandimet e shprehura këtu janë të zbatuesit, autorit (ëve) dhe nuk pasqyrojnë ato të qeverisë amerikane.

Rreth projektit

Projekti "Stimulimi i aktivizmit qytetar për monitorimin dhe raportimin e veprimeve të paligjshme të vetadministrimit lokal" zbatohet nga Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim - IHSE gjatë periudhës shtator 2019- shtator 2020. Ky projekt është mbështetur pjesërisht nga Ambasada e SHBA-së në Shkup.

Ky projekt ka për qëllim të nxisë interesin e qytetarëve në implementimin e disa ligjeve kryesore për realizimin e të drejtave të tyre në nivel lokal.

Në kuadër të këtij projekti IHSE ka përgatitur këtë Studim themelor ku janë të përfshirë Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik dhe Ligji për veprim ndaj parashtrësve dhe propozimeve. Gjithashtu do të përgatitet edhe një raport i veçantë monitorimi në lidhje me realizimin e të drejtave të qytetarëve në pesë qytetet e përzgjedhura (Shkup, Manastir, Strugë, Tetovë dhe Shtip) ku do të prezantohen konkluzionet nga monitorimi i realizuar përmes kërkesave për qasje të lirë në informata me karakter publik, të cilat janë paraqitur tek institucionet e përzgjedhura, si dhe do të mundësohet mbështetje mentorale për pesë medime dhe pesë shoqata/hulumtues në qytetet e lartpërmendura.

Përmes aktiviteteve të këtij projekti, përfshirë këtu edhe përgatitjen e këtij studimi, ne dëshirojmë të nxisim interesin e qytetarëve në realizimin e të drejtave të tyre në nivel lokal, veçanërisht në funksion të parandalimit të veprimeve të paligjshme të autoriteteve shtetërore.

Gjetjet Kryesore

Bazuar në hulumtimin e bërë mbi mundësitë e implementimit të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik dhe Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dalin në pah këto të gjetura kryesore:

- Ekziston një mungesë e ndërgjegjësimit të përgjithshëm tek qytetarët dhe institucionet në lidhje me mundësitë që ofron legjislacioni ekzistues në drejtim të përmirësimit të transparencës, përfshirë këtu edhe nivelin lokal;
- Duke pasur parasysh faktin se këto ligje përmbajnë mjete për transparencë dhe llogaridhënie për punën e subjekteve juridike publike është e këshillueshme që disa nga rregulloret e analizuara të integrohen në një tekst ligjor. Kjo veçanërisht i referohet mekanizmave, procedurave dhe mjeteve të ndryshme të parapara në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve dhe Ligjin për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve. Pastaj duhet marrë parasysh edhe specifikat e procedurave për shqyrtimin e parashtresave dhe denoncimeve të mbrojtur. Në esencë, kemi të bëjmë me ligje që kanë po të njëjtin qëllim, e ai është denoncimi i veprimeve të paligjshme, joetike dhe të papërshtatshme nga ana e subjekteve juridike publike.
- Integrimi i rregulloreve nënkupton edhe integrim të resurseve, me çka do të arrihet edhe ngritja e kapaciteteve. Mendojmë se do të ishte më e përshtatshme që i njëjti person t'i shqyrtojë parashtresat, denoncimet në formë të denoncimit të brendshëm të mbrojtur, si dhe kërkesat për qasje të lirë në informata me karakter publik;
- Si formë për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të mëdha në nivel nacional ose lokal ne propozojmë:

- o Formimin e një njësie të veçantë organizative për transparencë dhe llogaridhënie e cila do t'i shqyrtojë parashtresat, denoncimet në formë të denoncimit të brendshëm të mbrojtur si dhe kërkesat për qasje të lirë në informata me karakter publik, ose përcaktimin e një personi të veçantë, detyra e vetme e të cilit do ishte trajtimi i këtyre situatave. Kjo qasje do të bazohet në konceptin Compliance Officer.
- o Parashikimin e kualifikimeve të veçanta arsimore për personin/at që punojnë dhe veprojnë ndaj parashtresave, denoncimeve në formë të denoncimit të brendshëm të mbrojtur si dhe kërkesave për qasje të lirë në informata me karakter publik. Kjo qasje është e incorporuar në Rregulloren për denoncimin e brendshëm të mbrojtur në sektorin publik, ku në nenin 3 parashihet që personi i autorizuar për shqyrtimin e denoncimeve duhet të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën e drejtësisë, sigurisë ose shkencave ekonomike. Nëse i njëjti person zbaton të tre ligjet, do të mundësohet që personi me kualifikimet e duhura arsimore të veprojë në të tre situatat e përcaktuara me të tre ligjet. Përveç kësaj, rekomandojmë rritjen e resurseve njerëzore duke organizuar trajnime, kurse ose seminare.
- Duke pasur parasysh të dhënat statistikore që i kemi në dispozicion, denoncimi anonim duhet të inkurajohet si me Ligjin për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve ashtu edhe me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve. Kjo mund të arrihet duke plotësuar legjislacionin në mënyrë që të krijohet një mjedis për denoncim anonim;
- Është e domosdoshme mbrojtja shtesë e personit zyrtar i cili zbaton ligjet e lartpërmendura. Në situata të caktuara përveç denoncuesit, në rrezik mund të jetë edhe personi zyrtar. Në këtë drejtim është e nevojshëm të plotësohen ligjet ekzistuese në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e personit zyrtar nga pasojat e mundshme në vendin e tij të

punës. Një shembull i tillë mund të jenë dispozitat e nenit 33 të Ligjit për prokurim publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 14/2019) i cili parasheh mekanizma mbrojtës që lidhen me vendin e punës së personit zyrtar i cili është përgjegjës për prokurimin publik;

- Ekziston nevoja për të krijuar një sistem elektronik për paraqitjen e parashtresave, denoncimeve dhe kërkesave për qasje të lirë. Për më tepër, ky sistem duhet të sigurojë mundësi teknike për të ndjekur fazat e veprimit ndaj parashtresës përkatëse. Në këtë mënyrë, parashtruesi në çdo moment do të jetë i informuar për ecurinë e procedurës së shqyrtimit të parashtresës së tij, kërkesës për qasje të lirë apo denoncimit;
- Publikimi i parashtresave, denoncimeve si dhe përgjigjeve të kërkesave për qasje të lirë në informata me karakter publik. Kjo mund të arrihet me plotësimin e legjislacionit ekzistues. Në këtë mënyrë do të rritet niveli i transparencës, llogaridhënies si dhe niveli i publikimit të punës së institucioneve. Sigurisht, kjo zgjidhje potenciale duhet ketë parasysh edhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Në aspekt të publikimit, rekomandojmë që çdo institucion i cili zbaton ligjet në fjalë, t'i publikojë, para se gjithash në faqen zyrtare të internetit, raportet e veprimit në bazë të ligjeve përkatëse. Në këtë mënyrë, organizatat civile dhe mediumet do mund të monitorojnë më lehtë dhe më thjeshtë punën e institucioneve në këtë fushë.

Hyrje

Pjesëmarrja e qytetarëve, organizatave civile si dhe të sektorit më të gjerë civil në kontrollin e punës së institucioneve në nivel qendror dhe atë lokal është kushti kryesor për krijimin e një sistemi institucional transparent dhe llogaridhënës. Me qëllim të nxitjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve në nivelin lokal, Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim është duke zbatuar projektin “Stimulimi i aktivizmit qytetar për monitorimin dhe raportimin e veprimeve të paligjshme të vet administrimit lokal” (Boosting Citizens’ Activism to Monitor and Report Unlawful Conduct of Local Administration).

Gjatë përgatitjes së projektit, nga IHSE u morën në konsideratë tre ligjet e mëposhtme: Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik dhe Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve. Kemi konsideruar se kemi të bëjmë me ligje kyçe të cilat përmbajnë mjete të rëndësishme përmes së cilave personave fizik dhe juridik u mundësohet t’i denoncojnë veprimet e paligjshme, të paautorizuara dhe joetike të institucioneve në nivel nacional dhe atë lokal apo t’u sigurohen (marrin) informacione përkatëse për punën e institucioneve publike.

Sipas Raportit vjetor nga regjistri i të punësuarve në sektorin publik për vitin 2018 të Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në sektorin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë 1,314 institucione aktive, në të cilat marrëdhënie pune kanë gjithsej 132,068 persona. Kjo do të thotë se mjetet për transparencë dhe llogaridhënie, ku janë të përfshira parashtresat dhe propozimet sipas Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, denoncimet sipas Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve si dhe kërkesat për qasje të lirë sipas Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter

publik, potencialisht mund të përdoren për të monitoruar të gjitha këto 1,314 institucione. Nga numri i përgjithshëm i institucioneve, në nivel lokal në vitin 2018 kanë vepruar gjithsej 792 institucione, ndërsa në nivel nacional 522 institucione.

Si themelues i institucioneve të sektorit publik paraqitet: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qyteti i Shkupit si dhe njësiti e vetadministrimit lokal. Ndërsa për institucionet e pavarura si dhe institucionet të cilat dalin drejtpërdrejt nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut siç është Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Avokati i popullit, Banka popullore, gjykatat, prokuroritë publike si dhe Këshilli gjyqësor, si themelues paraqitet Republika e Maqedonisë së Veriut.

Ky studim ka për qëllim t'i analizojë mangësitë e mundshme të kornizës aktuale ligjore. Në veçanti, theksi duhet të vihet në dispozitat e këtyre ligjeve të cilat duhet të afirmohen nga institucionet dhe sektori civil. Për me tepër, të tregohet se si dhe me çfarë mjetes mund të përmirësohet zbatimi i këtyre zgjidhjeve ligjore. Është fakt që në Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik, i miratuar në maj të vitit 2019, i cili hyri në fuqi në nëntor 2019, janë të inkorporuar standardet botërore për të siguruar punë transparente të institucioneve, por ajo që vijon më tej është monitorimi i zbatimit të këtij ligji. Paralelisht, ky studim do të përdoret për përgatitjen e Raportit të monitorimit të komunave dhe institucioneve të përzgjedhura, si dhe në organizimin e trajnimeve të parashikuara në kuadër të këtij projekti.

LIGJI PËR VEPRIM NDAJ PARASHTRESAVE DHE PROPOZIMEVE¹

Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve ka hyrë në fuqi që nga viti 2008 dhe është ligji më gjatë i zbatuar në krahasim me ligjet tjera të analizuara për nevojat e këtij studimi. Deri në miratimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve në vitin 2015, krahas denoncimit standard të veprave penale, ky ligj ka qenë mjeti i vetëm i cili u mundësonte qytetarëve të denoncojnë veprimet e paligjshme, të paautorizuara dhe joetike të përfaqësuesve të institucioneve, përfshirë këtu edhe nivelin lokal.

Në nenin 1 të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve parashihet se cilat institucione janë të përfshira në këtë ligj, përkatësisht cilat subjekte juridike i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji. Në këtë drejtim, zbatimit të këtij ligji i nënshtrohen:

- Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Gjykatat;
- Organet e administratës publike;
- Njësitë e vetadministrimit lokal;
- Institucionet dhe shërbimet publike si dhe organet dhe organizatat tjera të cilat kryejnë autorizime publike.

¹ Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.82/2008, 13/2013, 156/2015 dhe 193/2015)

Ky përkufizim është më i ngushtë dhe përjashton disa subjekte të caktuara siç janë shoqëritë aksionare në pronësi të shtetit apo çfarëdo forme të shoqërive tregtare. Megjithatë, për dallim nga Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, këto subjekte tregtare shtetërore janë të përfshira në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve.

Në nenin 2 të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve është i definuar nocioni parashtresë, respektivisht nocioni propozim. Sipas kësaj dispozite, me parashtresë, respektivisht propozim nënkuptohet çdo adresim me shkrim ose gojarisht e parashtruesve deri tek organet të cilat veprojnë ndaj parashtresave, respektivisht propozimeve, me qëllim të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave dhe interesave të tyre, interesave publike të përcaktuara me ligj ose për shkak të ngritjes së ndonjë iniciative tjetër me interes publik, përveç paraqitjeve me shkrim ose me gojë (kërkesë për ngritje të procedurës për realizimin e të drejtave apo interesave juridike, iniciativë për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese apo llojit tjetër të mbikëqyrjes) nga përmbajtja e të cilave del kërkesa nga parashtruesi për ngritjen e procedurës që është rregulluar me ligj të veçantë.

Është e një rëndësie të veçantë që qytetari të njihet me nocionet parashtresë dhe propozim, përkatësisht, në cilat situata (për çfarë) mund të paraqesë një parashtresë dhe për cilat çështje një propozim. Në këtë mënyrë qytetari do jetë i informuar se ekziston një dallim midis paraqitjes së kërkesës për realizimin e një të drejte të caktuar në një procedurë administrative dhe paraqitjes së parashtresës kur ai/ajo konsideron se një organ i caktuar i kryen detyrat e tij në mënyrë joetike, jo të rregullt dhe jotransparente apo kur me një veprim të caktuar rrezikohet interesi publik.

Në nenin 3 të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve është e përcaktuar se cili person mund të paraqet një parashtresë, respektivisht propozim. Kështu që, parashtrues i parashtresës, respektivisht propozimit mund të jetë çdo person fizik apo juridik. Kjo do të thotë se për dorëzimin e një

parashtrese apo propozimi nuk kërkohet të ekzistojë një marrëdhënie juridike me institucionin siç parashihet në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve.

Në nenin 3, paragrafi (2) të këtij ligji, si kornizë mbrojtëse për parashtresin parashihet se parashtresi i parashtresës, respektivisht propozimit nuk mund të thirret në përgjegjësi as të pësojë çfarë do pasojash të dëmshme për shkak të parashtrimit të parashtresës, respektivisht propozimit dhe shfaqjes së qëndrimeve dhe mendimeve, përveç nëse me këtë nuk është bërë vepër penale.

Sipas neneve 2 dhe 4 të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, parashtresat, respektivisht propozimet paraqiten në formë të shkruar ose gojarisht në procesverbal, veçmas ose në grup. Duke pasur parasysh që ky ligj është i miratuar në vitin 2008, ajo që duhet të theksohet është mungesa e një formulimi në ligj i cili parasheh mundësinë e paraqitjes së parashtresës përmes një formulari elektronik apo përmes postës elektronike. Gjegjësisht, në ligj parashihet forma me shkrim. Nga ana tjetër, sipas Rregullores për mënyrën e veprimit ndaj parashtresave dhe propozimeve (Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 2/2009), në nenin 2 thuhet “Parashtresat, respektivisht propozimet paraqiten në formë të shkruar (në mënyrë të drejtpërdrejtë tek organet apo përmes postës), në mënyrë elektronike apo gojarisht në procesverbal, veçmas ose në grup”. Mirëpo, neni 3 i së njëjtës Rregullore ku thuhet “parashtresa e dorëzuar në formë elektronike duhet të përmbajë nënshkrim elektronik” është kufizues në dy aspekte, së pari, jo çdo qytetar, aktivist civil apo organizatë civile ka një nënshkrim elektronik dhe së dyti, një kusht i tillë pamundëson paraqitjen anonime të parashtresës në formë elektronike.

Organi i cili shqyrton parashtresat dhe propozimet nuk vepron ndaj një parashtrese, respektivisht propozimi anonim, përveç nëse bëhet fjalë për çështje të interesit publik i përcaktuar në ligj. Kemi të bëjmë me një dispozitë e cila len hapësirë për keqpërdorime në praktike. Edhe pse ligji lejon denoncimin anonim, përsëri ai do të jetë relevant vetëm nëse organi i cili vendos vlerëson se bëhet

fjalë për çështje të interesit publik. Për shkak të kësaj të drejte diskrete të organit i cili vendos, parashtresat të cilat implikojnë keqpërdorime të mëdha, por të paraqitura në mënyrë anonime shumë lehtë mund të refuzohen.

Si rregull i përgjithshëm, në nenin 4, paragrafi (2) të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve është përcaktuar që për parashtresa, respektivisht propozime nuk paguhet taksë.

Sipas nenit 4, paragrafit (2) të Ligjit parashihet se organet të cilat veprojnë ndaj parashtresave, respektivisht propozimeve mbajnë evidencë për parashtresat dhe propozimet e pranuar.

Ajo që është e rëndësishme është dispozita e nenit 4, paragrafi (4) të Ligjit sipas së cilës parashtresa, respektivisht propozimi i cili i është drejtuar organit kompetent evidentohet në evidencën e atij organi dhe pa prolongim i dorëzohet organit kompetent.

Ky nen, edhe pse në shikim të parë nuk duket i tillë, është shumë i rëndësishëm për punën e mëtutjeshme të institucioneve, por edhe për ngritjen e besimit të qytetarëve tek institucionet. Gjegjësisht, mbajtja e evidencës nuk paraqet vetëm një veprim të caktuar, por implikon edhe disa efekte të mëvonshme. Kjo evidencë duhet të shërbejë për të na dhënë një pasqyrë se si duhet të përmirësohen gjërat në këtë çështje. Përkatësisht, me mbajtjen e evidencës autoritetet kanë qasje në të gjitha të dhënat, siç janë: kush e ka paraqitur parashtresën apo propozimin, cilat kanë qenë qëllimet, cilat janë çështjet më të shpeshta për paraqitjen e një parashtrese apo propozimi, si dhe në lidhje me atë se në çfarë mënyre dhe si ka vendosur autoriteti, përkatësisht a është zhvilluar procedura në mënyrë efikase, efektive dhe transparente, cili është rezultati nga procedura e zhvilluar etj. Prandaj është shumë e rëndësishme që të gjitha këto të dhëna të përfshihen vazhdimisht në raportet vjetore dhe të njëjtat të publikohen në faqet e internetit të institucioneve.

Procedura për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve është e rregulluar me nenet 5 deri 20 të Ligjit. Ky grup i dispozitave ligjore përcakton detyrimet që duhet të ndiqen nga autoriteti i cili vepron ndaj një parashtrese dhe propozimi të caktuar.

Në këtë drejtim, një nga detyrimet e veçanta të organit i cili vepron ndaj propozimeve dhe parashtresave është edhe detyrimi për evidentimin e parashtresës apo propozimit.

Sipas dispozitave të Ligjit e në veçanti nenit 5, paragrafi (2), organi, të cilit i është parashtruar propozimi apo parashtresa, gjatë veprimit duhet:

- a. të konstatojë se me parashtresën ngritët çështje që është në kompetencën e tij dhe se është i detyruar të veproj ndaj parashtresës apo propozimit; apo
- b. nëse konstaton se nuk është kompetent, por për këtë çështje është kompetent një tjetër organ, parashtresën, respektivisht propozimin ex officio ia dërgon organit kompetent. Në këtë rast, nëse parashtresa apo propozimi i përcillet një organi tjetër, atëherë menjëherë për këtë informohet edhe parashtruesi.

Në nenin 5, paragrafi (3) të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve parashihet se nëse parashtresa, respektivisht propozimi i dërgohet më shumë organeve të cilat veprojnë ndaj parashtresave dhe propozimeve, organet do të bashkëpunojnë dhe do t'i koordinojnë veprimete tyre. Kështu që, duhet të kihet parasysh neni 5, paragrafi (2), sipas të cilit në rastin konkret, të gjitha organet të cilat veprojnë ndaj parashtresave, respektivisht propozimeve duhet të jenë kompetent për të vepruar ndaj parashtresës, respektivisht propozimit përkatës. Në lidhje me këtë, duhet pasur parasysh edhe dispozitat e ligjit të cilat janë shkelur e të cilave i referohet parashtresa përkatëse.

Në nenin 5, paragrafi (1), parashihet se organi është i detyruar që pas pranimit të parashtresës, respektivisht propozimit menjëherë ta trajtojë të njëjtën, me çka inicohet zbatimi i parimit të urgjencës për veprim edhe pse ky parim nuk është i parashikuar në mënyrë specifike në këtë ligj.

Në aspektin procedural, afatet janë të rregulluara në nenin 9. Sipas këtij neni, organi i cili vepron ndaj parashtresave dhe propozimeve është i detyruar t'i përgjigjet parashtruesit për bazueshmërinë dhe rezultatet e veprimit në afat prej 15 ditësh, ndërsa për çështje të komplikua në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të parashtresës, respektivisht propozimit.

Kur organi i cili vepron ndaj parashtresave dhe propozimeve do të vlerësojë se është e nevojshme që parashtresa, gjegjësisht propozimi të precizohet dhe të paraqiten dëshmi gjatë shqyrtimit, këtë mund ta kërkojë nga parashtruesi, dhe në atë rast afati nga paragrafi 1 i këtij neni fillon të rrjedhë nga fillimi.

Gjatë trajtimit të parashtresave dhe propozimeve, Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve parasheh detyrimin që organi të veprojë në mënyrë aktive. Gjegjësisht, kjo do të thotë se Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve kërkon nga autoriteti i cili vepron ndaj parashtresave apo propozimeve:

- Grumbullimin e të dhënave, informacioneve dhe opinioneve në lidhje me fakte dhe rrethana të rëndësishme për vlerësimin e tyre;
- Ekzaminim, analizë dhe evidentim të menjëhershëm të dukurive dhe arsyeve të parashtrimit të tyre si dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të nevojshme për realizimin e të drejtave të parashtruesit apo mbrojtjen e interesit publik të përcaktuar me ligj.

Neni 12 i Ligjit rregullon bashkëpunimin ndërmjet organeve. Përkatësisht, sipas këtij neni, organet të cilat veprojnë ndaj parashtruesve dhe propozimeve janë të detyruara që me kërkesën e organit i cili vepron ndaj parashtresës ose propozimit konkret, t'ia japin sqarimet dhe të dhënat e nevojshme për çështjet të

cilat kanë të bëjnë me parashtresën, respektivisht propozimin, si dhe të njoftohet për ndërmarrjen e masave ndaj parashtresave, respektivisht propozimeve të caktuara në afat të cilin do ta caktoj ai, e që nuk mund të jetë me i gjatë se 15 ditë. Ky nen në të ardhmen do të duhet të harmonizohet me Ligjin për Procedurën e përgjithshme administrative i vitit 2015, në të cilin neni 29 i cili ka të bëjë me Ndihmën juridike është e paraparë "Çdo organ është i obliguar të kërkojë ndihmë juridike në mënyrë elektronike kur ka nevojë për fakte, dokumente ose prova të tjera të cilat i posedon ndonjë organ tjetër ose kur nuk është në gjendje për arsye juridike të kryejë veprimin e nevojshëm administrativ. Organi publik nga i cili është kërkuar ndihmë është i detyruar menjëherë të veproj sipas kërkesës, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës dhe në mënyrë elektronike të dorëzoj faktet e kërkuara, dokumentet dhe dëshmitë e tjera. Nëse organi nga i cili është kërkuar ndihmë nuk vepron sipas afatit të përcaktuar sipas nenit 29 paragrafi (2), organi i cili kërkon ndihmë juridike mund t'i drejtohet organit përgjegjës për kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit të organit kërkuar. Nëse për dhënien e ndihmës juridike janë të nevojshme shpenzime të veçanta ndërmjet organeve shtetërore dhe organeve të vet administrimit lokal, ndihmë juridike sigurohet kur organi i cili kërkon ndihmën do të sigurojë mjetet e nevojshme.

Përveç kësaj, në përputhje me nenin 16 të Ligjit, gjatë veprimit ndaj parashtresave, respektivisht propozimeve, organet të cilat veprojnë, bashkëpunojnë në mënyrë reciproke dhe japin ndihmë juridike dhe ndihmë tjetër profesionale, shkëmbejnë eksperiencë, planifikojnë dhe me marrëveshje ndërmarrin aktivitete në kompetencë të tyre për çështjen e theksuara në parashtresë, respektivisht në propozim.

Mënyra e veprimit ndaj parashtresave dhe propozimeve të organeve përcaktohet nga ministri për shoqëri informatike dhe administratë.

Në nenin 7 të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve është paraparë që organi i cili vepron ndaj parashtresave dhe propozimeve është i detyruar të caktojë një ose më shumë persona të autorizuar të cilët do të veprojnë ndaj parashtresave dhe propozimeve në kuadër të organit, ose të formojë njësi të brendshme organizative për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, në pajtim me Aktin për organizim dhe sistematizim.

Në mënyrë që të shihet se sa prej institucioneve e zbatojnë këtë nen të Ligjit, është e nevojshme që në të ardhmen të behet kontrolli i Rregulloreve për sistematizim të vendeve të punës dhe Rregulloreve për organizim të brendshëm.

Në nenin 10 të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve është i rregulluar raporti i procedurës për veprim ndaj propozimit apo parashtresës me procedurat tjera përkatëse. Gjegjësisht, kur organi i cili vepron ndaj parashtresave dhe propozimeve konstaton se parashtresa, respektivisht propozimi ka të bëjë me çështje juridike ndaj së cilës nuk ka filluar procedurë, e informon parashtruesin se mund të ngrejë procedurë përkatëse. Për më tepër, nëse organi i cili vepron ndaj parashtresave dhe propozimeve konstaton se për çështjen e theksuar në parashtresë, respektivisht në propozim është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore apo ndonjë tjetër procedurë, për këtë do ta informojë parashtruesin.

Sipas nenit 11 të Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, kur parashtresa, respektivisht propozimi ka të bëjë me çështje ndaj së cilës tani më është vepruar ose është mbajtur procedurë tjetër nga organi kompetent, veprimi ndaj parashtresës, respektivisht propozimit të riparashtruar do të përsëritet vetëm nëse me parashtresën, respektivisht propozimin janë paraqitur fakte dhe rrethana të reja të cilat nuk kanë qenë të njohura në veprimin paraprak, respektivisht gjatë zhvillimit të procedurës. Kjo do të thotë se parashtruesi ka të drejtë për të njëjtën çështje të paraqesë një parashtresë, përkatësisht propozim të ri nëse me parashtresën, respektivisht propozimin e ri paraqet edhe fakte dhe rrethana të reja.

Sipas nenit 15 të Ligjit, nëse gjatë veprimit ndaj parashtresës, respektivisht propozimit konstatohet se parashtresit me ndonjë akt, veprim ose masë i është cenuar ndonjë e drejtë ose i është shkaktuar dëm, respektivisht është cenuar interesi publik i përcaktuar me ligj, organi i cili vepron ndaj parashtresës, respektivisht propozimit do ta paralajmëroj organin kompetent ose do të kërkojë të ndërmerren masa të nevojshme sipas ligjit me qëllim të mënjanimi të shkeljes të së drejtës, respektivisht dëmit të shkaktuar. Në rast se nuk veprohet sipas paralajmërimit të parashtruar nga neni 1, organi i cili vepron ndaj parashtresës, respektivisht propozimit, do ta njoftojë për këtë organin i cili bën mbikëqyrjen e punës së tyre që të ndërmerren masa adekuate në pajtim me ligjin.

Organet të cilat veprojnë ndaj parashtresave dhe propozimeve së paku një herë në vit i shqyrtojnë çështjet dhe problemet të cilat ngrihen me parashtresat, respektivisht propozimet, si dhe shkaqet për parashtrimin e tyre.

Organet të cilat veprojnë ndaj parashtresave dhe propozimeve i përcjellin situatat dhe dukuritë, i analizojnë shkaqet dhe çështjet e ngritura me parashtresat, respektivisht propozimet, ndërmarrin masa në kuadër të kompetencave të tyre dhe i informojnë organet tjera kompetente për situatat dhe problemet në fushën përkatëse me qëllim të marrjes së masave të cilat janë në kompetencë të tyre.

Në neni 18 parashihet se nëse parashtresuesi nuk merr përgjigje për parashtresën, respektivisht propozimin e parashtruar, ai mund t'i drejtohet dhe të kërkojë mbrojtje nga Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë. Në esencë, kjo dispozitë nuk është se ofron mbrojtje efektive në praktikë.

Sa i përket mbajtës së evidencës, detyrimet e organeve që veprojnë ndaj parashtresave dhe propozimeve janë të rregulluara në nenin 19 të Ligjit.

Zbatimin e këtij ligji e mbikëqyr Ministria për shoqëri informatike dhe administratë.

Pjesa e fundit e Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve përmban dispozitat kundërvajtëse. Kështu, janë paraparë dënime të posaçme: për kundërvajtje të funksionarit i cili udhëheq me organin, respektivisht personit udhëheqës, të cilit i është dorëzuar parashtresa, gjegjësisht propozimi, nëse i njëjti nuk ka caktuar person të autorizuar, i cili në kuadër të organit do të veprojë ndaj parashtresave dhe propozimeve apo nuk është formuar njësi e brendshme organizative, në pajtim me Aktin për organizim dhe sistematizim, për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, me tej, për kundërvajtje të funksionarit i cili udhëheq me organin, përkatësisht të personit udhëheqës nëse nuk i paraqet raport Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë, për kundërvajtje të personit zyrtar i cili në pajtim me nenin 7 të këtij ligji është i përcaktuar të veprojë ndaj parashtresave, përkatësisht propozimeve, edhe atë nëse: 1) nuk ia dorëzon parashtresën, respektivisht propozimin organit kompetent ose nuk e njofton parashtresin se parashtresa, respektivisht propozimi i është dërguar organit tjetër në pajtim me nenin 5, paragrafi (2) të këtij ligji; 2) nuk e njofton parashtresin e parashtresës, respektivisht të propozimit për bazueshmërinë dhe për rezultatet nga veprimi në afatin e përcaktuar me nenin 9, paragrafi (1) të këtij ligji; 3) me kërkesën e organit i cili vepron ndaj parashtresës ose propozimit konkret nuk ia jep sqarimet dhe të dhënat e nevojshme për çështjet të cilat nuk kanë të bëjnë me parashtresën, respektivisht propozimin, si dhe njoftimin për masat e ndërmarra për zgjidhjen e çështjes në pajtim me nenin 12, paragrafi (1) të këtij ligji; dhe 4) gjatë veprimit ndaj parashtresës, respektivisht propozimit vërtetohet se parashtresit me ndonjë akt, veprim ose masë i është cenuar ndonjë e drejtë apo i është shkaktuar dëm, respektivisht është cenuar interesi publik i përcaktuar me ligj, ndërsa organi i cili vepron ndaj parashtresës, respektivisht propozimit nuk do ta paralajmërojë organin kompetent si dhe nuk do të kërkojë të ndërmerren masat e nevojshme në pajtim me ligjin për evitimin e cenimit të së drejtës, respektivisht dëmit të shkaktuar në pajtim me nenin 15, paragrafi (1) të këtij ligji.

Organ kompetent për të vepruar si dhe për të kërkuar përgjegjësi kundërvajtëse është inspektorati administrativ i cili është i detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse në pajtim me Ligjin për kundërvajtje. Sipas nenin 22 të Ligjit, për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, gjykata kompetente zhvillon procedurë kundërvajtëse si dhe shqipton sanksione kundërvajtëse.

Rekomandime dhe gjetje:

- Është e nevojshme që Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve t'i përfshijë të gjitha format e personave juridikë të themeluar dhe/ose që janë në pronësi dominuese të shtetit, përkatësisht njësitë e vet administrimit lokal, siç janë ndërmarrjet tregtare të themeluara dhe/ ose në pronësi dominuese të shtetit, gjegjësisht njësitë e vet administrimit lokal. Bëhet fjalë për subjekte të mëdha juridike të cilat punësojnë një numër të madh personash si dhe disponon me mjete të shumta dhe për këtë arsye janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të ndryshme.
- Ligji duhet në mënyrë precize t'i përfshijë të gjitha subjektet juridike të themeluara dhe të menaxhuara nga subjektet e së drejtës private, por të cilave u është besuar kryerja e autorizimeve publike dhe/ose shërbimeve publike (përfshirë këtu: noterët, përmbauesit, administratorët e falimentimit) si dhe format e ndryshme të asociimit të partneritetit publiko-privat.
- Në Ligjin për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve duhet të parashikohet në mënyrë të qartë dhe të saktë mundësia për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve të parashtruara në mënyrë elektronike përmes formularëve elektronik të disponueshëm në faqet e internetit të institucioneve, pa kërkuar të ketë një nënshkrim elektronik. Të rishqyrtohet dispozita e nenit 8 të Ligjit nëse ky nen paraqet një të drejtë

të pajustificuar diskrecionale, sipas së cilës organi mund të refuzojë të veprojë ndaj parashtresave anonime.

- Të parashihet edhe një procedurë e veçantë e publikimit të përgjigjeve në lidhje me parashtresat dhe propozimet. Detyrimi për publikimin e përgjigjeve të jetë veçanërisht i detyrueshëm për parashtresat e paraqitura në formë anonime, përndryshe parashtresit nuk do mund të jenë të informuar me përgjigjen në lidhje me parashtresën dhe e njëjta mund të mbetet e harruar në sirtar.
- Të parashihen mekanizma të veçantë mbrojtës për personat zyrtar të cilët veprojnë ndaj parashtresave dhe propozimeve. Mekanizmat e tillë do t'i referoheshin mbrojtjes në vendin e punës. Gjegjësisht, këta persona potencialisht janë të ekspozuar ndaj presioneve të menaxherëve, kështu që në këtë mënyrë do të sigurohej mbrojtja e tyre.
- Në nenin 18 të Ligjit parashihet edhe përfshirja e Avokatit të Popullit, por pa ndonjë kompetencë të veçantë. Nga ana tjetër, Ligji parasheh veprim të Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë si dhe të Inspektoratit administrativ. Duke pasur parasysh faktin se Ligji promovon kontroll të qytetarëve mbi institucionet, do të ishte më e përshtatshme nëse kontrollin mbi zbatimin e ligjt do ta kryente ndonjë institucion i pavarur, siç është Avokati i Popullit apo Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

LIGJI PËR MBROJTJEN E DENONCUESVE

Ligji për mbrojtjen e denoncuesve u miratua në vitin 2015²

Neni 1 i Ligjit përcakton qëllimin e ligjit si në vijim: “me këtë ligj rregullohet denoncimi i mbrojtur në sektorin publik dhe privat për mbrojtjen e interesit publik, të drejtat e denoncuesve dhe detyrimet e institucioneve, respektivisht personave juridik në lidhje me denoncimin e mbrojtur, si dhe mbrojtja e denoncuesve.

Sipas Nenit 2 paragrafi (1) të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, denoncimi i mbrojtur është denoncim, respektivisht zbulimi me të cilin në pajtim me këtë ligj bartet dyshimi racional ose informatë se është kryer, është duke u kryer ose me shume gjasë do të kryhet veprimi i ndëshkueshëm, jo etik apo veprim tjetër joligjor apo i palejuar me të cilin cenohet apo rrezikohet interesi publik.

Nga kjo dispozitë shihet qartë se bëhet fjalë për denoncim të: 1) veprimit ndëshkues, 2) veprimit jo etik dhe 3) veprimeve tjera joligjore dhe të paautorizuara të cilat cenojnë dhe rrezikojnë interesin publik.

Me interes të veçantë janë dispozitat e paragrafët (2) dhe (3) të nenit 2 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, me të cilat bëhet përcaktimi i denoncuesit. Në përputhje me këto dispozita, si denoncues konsiderohet personi i përcaktuar sipas dispozitave të paragrafit (3) të nenit 2 të Ligjit, i cili me qëllim të mirë kryen denoncim të mbrojtur sipas këtij ligji.

2 Nevoja përse është miratuar ky ligj është krijimi i një mjeti që do të mundësoj raportimin e veprimeve joligjore dhe krijimin e një kornize për trajtim efikas të raporteve të ashtuquajtura denoncime.

Sipas nenit 2, paragrafi (3), kategoritë e personave të cilët në pajtim me këtë ligj mund të paraqiten në cilësi të denoncuesve janë:

- Personi i cili ka marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar ose të caktuar në institucionin, respektivisht personin juridik për ku denoncon;
- Kandidati për punësim, kandidat për vullnetar ose praktikant në institucionin, respektivisht personin juridik për ku denoncon;
- Personi i cili është vullnetar apo praktikant në institucionin, respektivisht personin juridik për ku denoncon;
- Personi i cili në çfarëdo baze është apo ka qenë i angazhuar me punë nga institucioni, respektivisht personi juridik për ku denoncon;
- Personi i cili në çfarëdo baze është apo ka qenë në marrëdhënie afariste ose marrëdhënie tjetër bashkëpunimi me institucionin, respektivisht personin juridik për ku denoncon;
- Personi i cili shfrytëzon ose ka shfrytëzuar shërbime në institucionin, respektivisht personin juridik në sektorin publik dhe privat për ku denoncon;

Ajo që është me rëndësi, në përputhje me nenin 2, paragrafët (2) dhe (3) të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve duhet pasur parasysh faktin se ky Ligj kërkon ekzistimin e një marrëdhënie juridike midis personit denoncues, i cili bën raportim të mbrojtur sipas paragrafit (3) të nenit 2 të Ligjit, dhe institucionit të cilit i referohet denoncimi. Kështu që, parashtrohet pyetja a duhet personi i tretë të konsiderohet si denoncues nëse nuk ka lidhje juridike me institucionin siç është parashihet me Ligjin për propozime dhe parashtresa, sipas të cilit çdo person mund të paraqitet si parashtresë i propozimit.

Nga ana tjetër, është me rëndësi të theksohet se Ligji nuk kërkon që denoncuesi personalisht të ketë pësuar ndonjë dëm nga veprimi përkatës, por i njëjti mund të denoncoj edhe ndonjë veprim me të cilin cenohet interesi publik në përgjithësi. Sipas nenit 2, paragrafi (6) të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, me nocionin interes publik nënkuptohet mbrojtja e lirive themelore të njeriut dhe të qytetarit të pranuar me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me

Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, parandalimin e rreziqeve ndaj shëndetit, mbrojtja dhe siguria, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës, mbrojtja e pronës dhe lirisë së tregut dhe sipërmarrësisë, sundimi i së drejtës dhe parandalimin e krimit dhe korrupsionit.

Përfshirja e institucioneve të cilat i nënshtrohen Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve është më ekstensiv për dallim nga Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve. Sipas nenit 2 paragrafët (4) dhe (5) të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, me nocionin institucion nënkuptohet organ i pushtetit shtetëror dhe lokal, organ tjetër shtetëror i themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose nga komuna, Qyteti i Shkupit, komunat e Qytetit të Shkupit, si dhe institucion tjetër i regjistruar si person juridik në pronësi dominuese ose të plotë të shtetit.

Për më tepër, nocioni person juridik sipas këtij ligji nënkupton person juridik i regjistruar në Regjistrin tregtar ose persona të tjerë juridik të cilët udhëhiqen nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse i njëjti nuk është i përfshirë me nocionin institucion të paragrafit (4) të këtij neni. Në këtë mënyrë, për dallim nga Ligji për veprim ndaj parashtresave, në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve janë të përfshirë edhe një numër i madh personash juridik të cilët janë tejet të rëndësishëm si në aspekt të parave publike me të cilat disponojnë, po ashtu edhe numrit të punësuarve, xhiros dhe ngjashëm. Kjo i referohet shoqërive aksionare që janë në pronësi të shtetit apo çdo forme tjetër të shoqërive tregtare në pronësi të shtetit.

Neni 3 i Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve bën dallimin mes llojeve të mëposhtme të denoncimit të brendshëm: denoncim i brendshëm i mbrojtur, denoncim i jashtëm i mbrojtur apo denoncim i mbrojtur publik.

Denoncimi i mbrojtur kryhet si denoncim i brendshëm i mbrojtur, denoncim i jashtëm i mbrojtur apo denoncim i mbrojtur publik, në përputhje me nenin 3, 4

dhe 5 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve , në mënyrë anonime ose konfidenciale, me qëllim të mirë dhe bindje racionale gjatë denoncimit se informatat e dhëna janë të sakta. Sipas Ligjit për mbrojtje të denoncuesve, denoncimi mund të jetë anonim, ndërsa institucioni i cili ka pranuar denoncimin e denoncuesit anonim është i obliguar ta trajtoj të njëjtin.

Ligji për mbrojtjen e denoncuesve parasheh një kornizë të caktuar mbrojtëse të denoncuesit e cila duhet ta inkurajojë dhe ta nxisë denoncuesin. Përkatësisht me nenin 3, paragrafi (2) të Ligjit, denoncuesi nuk është i obliguar të dëshmoj qëllimin e mirë dhe vërtetësinë e denoncimit nga paragrafi (1) i nenit 3. Denoncuesit i sigurohet mbrojtje në pajtim me ligjin dhe i garantohet konfidencialitetet. E drejta e konfidencialitetit të denoncuesit mund të kufizohet me vendim gjyqësor, për të cilin vendim pa prolongim njoftohet denoncuesi.

Nga ana tjetër, Ligji për mbrojtjen e denoncuesve në nenin 14 rregullon keqpërdorimet e mundshme të denoncimit. Me Keqpërdorim të denoncimit nënkuptohet paraqitje e vetëdijshme e informatave të pavërteta për person fizik apo juridik me qëllim të shkaktimit të pasojave të dëmshme për të njëjtin. Keqpërdorim të denoncimit kemi edhe në rast se nuk ka kontrolluar me kujdesin e duhur dhe në mënyrë të ndërgjegjshme, deri në shkallë që këtë e lejojnë rrethanat, nëse ato janë të sakta dhe të besueshme. Me përcaktimin e keqpërdorimit të përmendur në paragrafin (1) dhe (2) të nenit 14, humbet mbrojtja e siguruar e denoncuesit në bazë të nenit 8 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Gjithashtu, në bazë të nenit 14, paragrafi 3, keqpërdorimi i denoncimit të denoncuesit për shkak të cilit janë paraqitur pasoja të dëmshme për personin fizik ose juridik është bazë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së tij në pajtim me këtë ligj.

Në bazë të neni 4 të Ligjit, denoncuesi kryen denoncim të mbrojtur në institucion, respektivisht personin juridik për ku ka dyshim ose informat se është kryer, kryhet ose do të kryhet vepër e ndëshkueshme, ose veprim tjetër joligjor ose i palejuar, me të cilin cenohet interesi publik.

Denoncim të mbrojtur denoncuesi kryen gojarisht në procesverbal ose me shkrim te personi i autorizuar nga personi udhëheqës në institucion, përkatësisht personin juridik ku denoncon.

Në institucionin, gjegjësisht personin juridik ku nuk ka person të autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncuesit, denoncimi i brendshëm i mbrojtur kryhet te personi udhëheqës i institucionit, përkatësisht personin juridik në formë të përcaktuar me paragrafin (2) të këtij neni.

Personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit, përkatësisht personi udhëheqës në institucion, përkatësisht personi juridik nga paragrafi (3) të nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, është i obliguar:

- Të veprojë ndaj denoncimit nga paragrafi (1) të nenit 4 me respektimin e procedurave të përcaktuara me aktin për denoncim të brendshëm;
- T'i mbrojë të dhënat personale të denoncuesit, përkatësisht të dhënat të cilat mund ta zbulojnë identitetin e denoncuesit i cili denoncon në mënyrë anonime ose konfidenciale, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ta informojë denoncuesin i cili është i njohur, për masat e ndërmarra në lidhje me denoncimin pa prolongim, më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të denoncimit.

Në nenin 5 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve definohet edhe denoncimi i jashtëm i mbrojtur. Gjegjësisht, denoncim të mbrojtur denoncuesi mund të kryejë edhe me denoncim tek Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria publike përkatëse, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë ose institucionet tjera përkatëse, përkatësisht persona juridik, nëse:

- Denoncimi nga neni 4 i këtij ligji është i drejtuar drejtpërdrejt apo tërthorazi kundër personit udhëheqës në institucion, përkatësisht personit juridik ku raporton ose

- Denoncuesi lidhur me denoncimin nuk informohet për masat e ndërmarra në afatin e përcaktuar me nenin 4 paragrafin (4) alineja 3 i këtij ligji ose
- Nuk janë ndërmarrë masa ose denoncuesi nuk është i kënaqur nga masat e ndërmarra ose dyshon se nuk do të ndërmerren masa ose që denoncimi i nenit 4 paragrafi (1) i këtij ligji do të shkaktojë pasoja të dëmshme për atë ose për persona të afërt të tij (në tekstin e më tutjeshëm: denoncim i jashtëm i mbrojtur).

Në bazë të nenit 5, paragrafi (2) të Ligjit, denoncimin e jashtëm të mbrojtur denoncuesi e kryen gojarisht në procesverbal ose me shkrim te personi i autorizuar, respektivisht te personi udhëheqës në institucion, përkatësisht personin juridik ku denoncon.

Në përputhje me dispozitat e nenit 3, si dhe dispozitën e nenit 5, paragrafi (3), denoncimi i jashtëm i mbrojtur gjithashtu mund të bëhet edhe në mënyrë anonime. Për më tepër, neni 5, paragrafi (3), përcakton se institucionet, respektivisht personat juridik tek të cilët denoncuesi ka kryer denoncimin e jashtëm janë të obliguar në suaza të kompetencave të tyre të veprojnë në bazë të denoncimit, t'i mbrojnë të dhënat personale të denoncuesit, respektivisht të dhënat të cilat mund ta zbulojnë identitetin e denoncuesit i cili denoncon në mënyrë anonime ose konfedenciale, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa për veprimet e ndërmarra ta infomrojë denoncuesin pa prolongim, më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të denoncimit.

Denoncimi i jashtëm i mbrojtur rregullohet me akt të cilin e miraton ministri i Drejtësisë.

Nëse institucioni, respektivisht personi juridik tek i cili denoncuesi e ka dorëzuar informatën nuk është kompetent të veprojë lidhur me denoncimin do ta përcjellë informatën tek organi kompetent në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi dhe për atë njëkohësisht do ta njoftojë denoncuesin.

Në bazë të nenit 5, paragrafi (2), institucioni, respektivisht personi juridik tek i cili denoncuesi e ka dorëzuar denoncimin është i detyruar: me kërkesë të denoncuesit t'i japë njoftim për rrjedhën dhe veprimet e ndërmarra në bazë të denoncimit; si dhe në bazë të ligjit t'i mundësojë denoncuesit qasje në shkresat e lëndës; pas përfundimit të procedurës, ta njoftojë denoncuesin i cili është i njohur, për rezultatet nga veprimi në bazë të denoncimit, në përputhshmëri me ligjin.

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, forma e tretë e denoncimit është denoncimi i mbrojtur publik. Në bazë të nenit 6 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, denoncuesi mund të kryen denoncim të mbrojtur edhe duke i vënë në dispozicion të publikut informacionet, me kusht që:

- Denoncimi nga nenet 4 dhe 5 të këtij ligji është bërë i pamundur për shkak të mos vendosjes së procedurës, respektivisht procedurës për pranimin e denoncimit në përputhje me ligjin, ose
- Denoncuesi në lidhje me denoncimin e mbrojtur të kryer në përputhje me ligjin, nuk merr informata për masat e ndërmarra në afatin e caktuar ligjor ose;
- Nuk janë marrë masa ose ekziston rrezik i identifikuar lehtësisht për shkatërrimi i provave ose ikjes nga përgjegjësia (në tekstin e mëtutjeshëm: denoncim publik i mbrojtur).

Duke pasur parasysh specifikat e denoncimit publik të mbrojtur, në nenin 6 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve parashihen disa kufizime në veprimin e denoncuesit. Gjegjësisht, denoncuesi i cili kryen denoncimin publik nuk guxon ti vënë në dispozicion të publikut:

- Të dhënat personale të subjektit të cilat nuk janë relevante për denoncimin e mbrojtur;

- Të dhënat, respektivisht informacionet të cilat në bazë të ligjit, konsiderohen si informata të klasifikuara në përputhje me rregulloret për informacionet e klasifikuara, si dhe të dhënat, respektivisht informatat që rrezikojnë zhvillimin e procedurave penale, kundërvajtjes ose procedurave civile, nëse janë të dhëna të cilat identifikohen lehtë dhe janë të menjëhershme;
- Të dhënat, përkatësisht informatat të cilat me bërjen publike të të njëjtave shkelet ose rrezikohet siguria kombëtare, mbrojtja e pavarësisë ose integriteti territorial i Republikës.

Ligji për mbrojtjen e denoncuesve në nenin 7, parashikon mekanizma për mbrojtjen e identitetit dhe të dhënave të denoncuesit. Përkatësisht, kjo dispozitë ndalon zbulimin ose mundësin e zbulimit të identitetit të denoncuesit pa pëlqimin e tij, përveç nëse kërkohet me vendim gjyqësor kur është e nevojshme të ngrihet procedurë para një organi kompetent. Për më tepër, personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit është i obliguar t'i mbrojë të dhënat e denoncuesit, respektivisht të dhënat me anë të cilave mund të identifikohet identiteti i denoncuesit, përveç nëse denoncuesi është i pajtimit t'i zbulojë ato, në pajtueshmëri me ligjin me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhënave personale. Ky detyrim vlen për çdo person tjetër që do t'i zbulohen këto të dhëna.

Për më tepër, në përputhje me nenin 7, paragrafin (4), personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesi është i detyruar gjatë pranimin të informacioneve, ta njoftojë denoncuesin se identiteti i tij mund të zbulohet para organit kompetent në bazë të paragrafit (1) të nenit 7 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, si dhe ta njoftojë atë për masat e mbrojtjes së pjesëmarrësve në procedurën penale.

Për zbulimin e identitetit të denoncuesit në bazë të vendimit gjyqësor në pajtueshmëri me paragrafin (1) të nenit 7 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit është i detyruar ta njoftojë denoncuesin para se ta zbulojë identitetin e tij.

Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është dispozita e nenit 7, paragrafi (6), në bazë të cilit të dhënat nga paragrafi (1) të nenit 7 nuk mund t'i zbulohen personit për të cilin sugjerohet në informatë.

Ligji për mbrojtjen e denoncuesve gjithashtu në nenin 8 përmban dispozita të caktuara në lidhje me mbrojtjen e denoncuesve nga pasojat e mundshme në vendin e punës. Përkatësisht, denoncuesit dhe anëtarëve të afërt të tij u' është siguruar mbrojtje kundër çdo lloji të shkeljes së të drejtave gjatë përcaktimit të përgjegjësisë, sanksioni, ndërprerja e marrëdhënies së punës, suspendimi i vendit të punës, sistemimi në vend pune tjetër që është më pak i volitshëm, diskriminim ose veprim të dëmshëm ose rrezik për paraqitjen e veprimeve të dëmshme për shkak të kryerjes së denoncimit të mbrojtur të brendshëm dhe të jashtëm ose denoncim të mbrojtur publik.

Sidoqoftë, ajo që duhet theksuar është se në asnjë dispozitë të nenit 8, me të cilën parashihet sigurimi i mbrojtjes së vendit të punës, nuk e përcakton qartë dhe saktë kohëzgjatjen në të cilën denoncuesit nuk mund t'i rrezikohet vendi i punës për shkak të denoncimit të bërë. Për këtë arsye dispozita ka më shumë karakter deklarativ. Për më tepër, procedura për realizimin e mbrojtjes në këtë situatë nuk është e precizuar mjaftueshëm. Përkatësisht, neni 8, paragrafi (3), përcakton që nëse nuk i sigurohet mbrojtja, denoncuesi për këtë do ta informojë Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë, Këshillin Inspektues, Ministrin e punëve të brendshme dhe Prokurorin Publike të Republikës, të cilët pas paraqitjes pa prolongim do të veprojnë në pajtueshmëri me kompetencat e tyre.

Neni 9 i Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, përpunon më detalisht procedurën e ndjekur nga autoritet e përmendura. Duhet të theksohet se, dispozita e nenit 9 paragrafi (5), përcakton që nëse e drejta e denoncuesit ose anëtarëve të familjes së tij apo të ndonjë personi të afërt me të i cenohen të drejtat, institucionet pa prolongim dhe brenda afatit prej tetë ditësh ngrisin iniciativë për ngritjen e procedurës për ndjekje penale, përkatësisht iniciativë për ngritje të procedurës

para autoriteteve kompetente për shkarkim, sistemim, ndërrim ose aplikim të masave tjera të përgjegjësisë së personave të zgjedhur ose të emëruar, personave zyrtar ose personave përgjegjës në ndërmarrje publike dhe persona të tjerë juridik që disponojnë me kapital shtetëror.

Neni 10 i Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve është me rëndësi të veçantë, i cili referohet situatave në të cilat denoncuesi ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore para gjykatës kompetente në përputhje me ligjin. Në bazë të paragrafit 2 nenit 10, denoncuesi ka mundësi që para gjykatës kompetente me anë të padis mund të kërkojë:

- Të përcaktojë se është ndërmarrë veprim i dëmshëm ose është shkelur e drejta për shkak të denoncimit të mbrojtur;
- Ndalesë të kryerjes së veprimit të dëmshëm ose shkeljes së të drejtës për denoncim të mbrojtur dhe përsëritjes së veprimit të dëmshëm ose shkeljes së të drejtës për denoncim të mbrojtur;
- Anulimin e aktit me anë të cilit është kryer veprim i dëmshëm ose shkelje e të drejtës për arsye të kryerjes së denoncimit të mbrojtur;
- Eliminimin e pasojave nga veprimi i dëmshëm apo shkeljes së të drejtës për shkak të denoncimit të mbrojtur;
- Kompensim të dëmit material dhe jo material për shkak të denoncimit të mbrojtur.

Garanci plotësuese për mbrojtjen e denoncuesit është edhe dispozita e nenit 11 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, i cili ka të bëjë me barrën e provës, sipas të cilit në rast të kontestit për ekzistim të shkeljes së të drejtës së denoncuesit dhe personave të afërt të tij për shkak të denoncimit, barra e provës është në anën e institucionit, përkatësisht personit juridik i cili ka shkelur të drejtat e denoncuesit dhe anëtarëve të familjes së tij.

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, dispozitat në marrëveshjet dhe aktet të cilat janë në lidhshmëri, gjegjësisht rregullohen marrëdhëniet dhe angazhimet e punës, me anë të cilave ndalohet denoncimi i dyshimit apo informacionit për vepër të ndëshkueshme ose veprim tjetër të

paligjshëm dhe të palejuar me të cilin shkelet ose rrezikohet interesi publik, siguria dhe mbrojtja ose një denoncim i tillë përkufizohet si shkelje të dispozitave për besueshmëri, lojalitet dhe profesionalizëm konsiderohen si të pavlefshme.

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, denoncuesi ka të drejtë të kompensimit të dëmit që ai ose një person i afërt me të mund ta pëson për shkak të denoncimit të mbrojtur. Kërkesa për kompensim të dëmit mund të realizohet me parashtrimin e padisë në gjykatën kompetente.

Në nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve është rregulluar roli i Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK). Në përputhshmëri me rregulloret e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, institucionet paraqesin raporte në KSHPK për veprimin e tyre në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve. Në ueb faqen e KSHPK është i publikuar vetëm një raport për denoncimet e pranuar prej denoncuesve edhe atë raport i vitit 2016. Ky raport në faqen 11 konstaton: “prej analizës së të gjitha raporteve të dorëzuara gjysmë-vjetore dhe vjetore u konstatua se nuk kishte denoncime nga denoncues në institucione publike ose private, kur bëhet fjalë për raportin të brendshëm të mbrojtur”. Në “Strategjinë Kombëtare për luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2020-2024)”³ të përgatitur nga KSHPK nuk parashikon asnjë masë për të forcuar kapacitetet për të inkurajuar zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Masa e vetme e përmendur është masa nga “Plani i veprimit” i cili parashikon që personi përgjegjës për marrjen e denoncimeve nga denoncuesit në modelet dokumentacioneve të tenderit.⁴

Prej akteve nënligjore në lidhje me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, në këtë studim, do të përfshijmë: Rregulloren për denoncim të

³ Në dispozicion në: <https://www.dksk.mk/index.php?id=118>, qasur në datë 4.2.2020.

⁴ Në dispozicion në: <https://www.dksk.mk/index.php?id=118>, qasur në datë 4.2.2020.

brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik⁵, Rregulloren për Denoncim të jashtëm të mbrojtur⁶ dhe Rregulloren për udhëzimet për sjelljen e akteve të brendshme për denoncim të brendshëm të mbrojtur te personat juridik në sektorin privat⁷.

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve kryen Ministria e Drejtësisë.

Nenet 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve parashikojnë gjobë të veçantë në rast të mosrespektimit të dispozitave të këtij Ligji.

Rekomandime

Duke u bazuar në analizën e kryer të ligjit, lindën disa ide dhe zgjidhje të mundshme për të përmirësuar zbatimin e tij. Në këtë drejtim, nevojitet:

- Zgjerimi i fushëveprimit të nenit 2, paragrafi (3) i Ligjit përkatësisht specifikimin e tij. Zgjerimi duhet të bëhet me përfshirjen e të gjitha atyre shoqërive tregtare të cilat paraqiten si ofertues në procedurat e prokurimit publik me të cilat nuk është lidhur kontratë. Dispozita aktuale e ligjit kërkon që personat të jenë të angazhuar në kryerjen e punës, ose të jenë në marrëdhënie biznesi ose në kushte të tjera bashkëpunimi me institucionin. Operatorët ekonomik me të cilët nuk është lidhur kontratë, nuk janë të angazhuar, gjegjësisht nuk janë në marrëdhënie biznesi ose marrëdhënie të tjera juridike me institucionin. Bëhet fjalë për fonde të mëdha financiare në procesin e prokurimit publik, kështu që përfshirja e këtyre subjekteve paraqet interes publik.
- Krijimi i mundësive dhe kapaciteteve që do të mundësojnë dhe inkurajojnë denoncimin anonim në bazë të nenit 3 paragrafi (1), nenit 5 paragrafi (4) i Ligjit. Në këtë drejtim duhet përgatitur udhëzime speciale

⁵ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 46 prej 8.03.2016.

⁶ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 46 prej 8.03.2016.

⁷ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 46 prej 8.03.2016.

me anë të cilave personi që pranon denoncimin të ketë kujdes të mos zbulohen të dhënat të cilat mund ta zbulojnë identitetin e denoncuesit (Shembull: Edhe pse bëhet fjalë për denoncim anonim, nëse në raport deklarohet se denoncuesi si kontabilist, ka denoncuar veprimtari të kundërligjshme, ndërsa në institucion ka vetëm një kontabilist, do të jetë e qartë se kush është denoncuesi).

- Emërimi i një personi zyrtar për pranimin e denoncimeve, të jetë rregull në persona juridik të mëdhenj. Kjo mund të lidhet me numrin minimal të të punësuarve ose qarkullimin minimal ose diçka të ngjashme. Përndryshe, nëse personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve është person në pozitë udhëheqëse, denoncuesit mund të dekurajohen të denoncojnë për shkak të pozitës hierarkike të udhëheqësit. Prandaj, me ndryshimet e nevojshme legislative, mund të kërkohet që personat juridik më të mëdhenj të kenë detyrim të përcaktojnë person zyrtar për të vepruar mbi denoncimet e denoncuesve, e mos të jetë nga rendi i zyrtarëve në pozita udhëheqëse.
- Sigurimi i masave të posaçme mbrojtëse për personin i cili vepron sipas denoncimeve të denoncuesve.

Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik

Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik⁸ është një mjet i veçantë në sistemin juridik të Maqedonisë Veriore që duhet t'u mundësojë të gjithë palëve të interesuara përmes përdorimit të këtij instrumenti të posaçëm (Kërkesë për qasje në informata me karakter publik) të sigurojnë informatat nga subjektet përkatëse, të cilat kanë karakterin e informatës publike. Qëllimi i këtij ligji është të krijoj institucion të përgjegjshme dhe transparente. Mjetet që burojnë nga ky ligj janë me interes të veçantë për përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, si dhe aktivistëve të cilët monitorojnë punën e institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal.

Në vitin 2006, në vendin tonë u miratua Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik, i cili ishte në fuqi deri në miratimin e Ligjit të ri për qasje të lirë në informata me karakter publik në vitin 2019.

Në bazë të nenit 3 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik, "posedues të informatave" janë organet e pushtetit shtetëror dhe organe si dhe organizata të tjera të përcaktuara me ligj, organet e komunave dhe komunat të Qytetit e Shkupit, institucionet dhe shërbimet publike, personat juridik dhe fizik që kryejnë autorizime publike, të përcaktuara me ligj dhe veprimtari me interes publik dhe partitë politike në pjesën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

⁸ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 6p. 101/2019.

Në bazë të nenit 3 të Ligjit, si “informatë me karakter publik” cilësohet informata në cilën do formë që e ka krijuar ose me të cilën disponon poseduesi i informatës në pajtim me kompetencat e veta.

Në kontekstin e kësaj dispozite është edhe përkufizimi i termi “dokument” i cili përcaktohet si çdo shkresë e informatës pa marrë parasysh formën e vet fizike ose karakteristikat, tekstin e shkruar ose të shtypur, hartat, skemat, fotografitë, vizatimet, skicat, materialet e punës, si dhe video incizime akustike, tonike, magnetike ose elektronike, optike ose video incizime në cilën do formë, si dhe pajisje bartëse për përpunimin automatik të të dhënave në memorie të instaluar ose bartëse për ruajtjen e të dhënave në formë digjitale. Në nenin 3 i Ligjit, si “kërkues i informatës” është përcaktuar çdo person juridik dhe fizik. Sipas nenit 4 të Ligjit, të gjithë personat juridik dhe fizik, përfshirë edhe personat e huaj fizike dhe juridikë, kanë qasje të lirë në informata.

Për më tepër, neni 2 i Ligjit gjithashtu përmban një përkufizim të termit “interes publik” në realizimin e të drejtës së qasjes në informata, nënkupton, pot nuk kufizohet, në interes për informata, me publikimin e të cilave, përkatësisht realizimin e qasjes:

- 1) Do të zbulohet keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe sjelljes korruptuese;
- 2) Do të zbulohet përvetësimi i paligjshëm ose shpenzimi i mjeteve buxhetore;
- 3) Do të zbulohet një konflikt i mundshëm i interesit;
- 4) Do të parandalohen dhe zbulohen kërcënime serioze për shëndetin dhe jetën e njerëzve;
- 5) Do të parandalohen dhe zbulohen rrezikimi i mjedisit jetësor;
- 6) Do të ndihmohet të kuptohet çështja për të cilën krijohet politika publike ose mbahet debat parlamentar dhe
- 7) Do të mundësohet trajtimi i barabartë i çdo qytetari para ligjeve.

Me qëllim që kërkuesi i informatës të njihet me entitetin dhe personin zyrtar ndaj të cilit drejtohet për të siguruar informata, në bazë të nenit 5 të Ligjit,

Agjencia për mbrojtjen të së drejtës për qasje të lirë në informata në internet faqen e vet publikon listë të poseduesve të informatave dhe të personave zyrtarë të poseduesve të informatave.

Në nenin 6 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik, janë të parashikuara disa përjashtime të caktuara ku poseduesi i informatave edhe pse posedon informatën e specifikuar, nuk ka detyrim ta përcjellë atë tek kërkuuesi. Gjegjësisht, poseduesit të informatave mund të refuzojnë kërkesën për qasje te:

1. Informata e cila në bazë të ligjit paraqet informatë të klasifikuar me shkallë adekuatë të klasifikimit;
2. Informata personale, zbulimi i të cilave do të nënkuptonte shkeljen e mbrojtjes së të dhënave personale;
3. Informata të cilat dhënia e tyre do të nënkuptonte shkeljen e besueshmërisë së procedurës tatimore;
4. Informata e fituar ose e përpiluar për hetim, procedim penal ose kundërvajtës, për zbatimin e procedurës administrative dhe civile, zbulimi i të cilave do të kishte pasoja të dëmshme për rrjedhjen e procedurës;
5. Informatat të cilat cenojnë të drejtat e pronësisë industriale apo intelektuale (patentë, model, mostër, vulë të mallrave dhe vulë shërbimi, shenja e origjinës së produktit).

Neni 6 paragrafi (3) gjithashtu parashikon edhe kryerjen e testit të dëmshmërisë. Përkatësisht, poseduesit e informatës do të lejojnë qasje në informata, pas zbatimit të testimit të detyrueshëm të dëmshmërisë, me anë së cilës përcaktohet se zbulimi i këtij lloji informate, do të ketë efekt mbi interesin e mbrojtur më pak se interesi publik i përcaktuar me ligj që do të arrihej me zbulimin e informatës. Në çdo rast, në situata të tilla, duhet të merret parasysh dispozita e nenit 6, paragrafi (4) i ligjit, sipas të cilit nëse dokumenti apo një pjesë

e tij përmban informata të përmendura në paragrafin (1) të këtij nenit, që mund të veçohet nga dokumenti pa rrezikuar sigurinë e tij, poseduesi i informatave i veçon ato informata nga dokumenti dhe e informon kërkuesin për përmbajtjen e pjesës tjetër të dokumentit. Në praktikë, kjo mund të shkaktojë disa dilema. Përkatësisht, mbetet hapësirë, nëse poseduesi i informatës nuk dëshiron të sigurojë informata përkatëse, të mbështetet në faktin se e njëjta nuk mund të veçohet. Për këto arsye, këshillohet, që qoftë me ndryshime në legjislacion, ose me mendim të Agjencisë, të specifikohet më saktësisht se çfarë nënkuptohet me veçimin e informacionit (vallë kjo do të bëhet me anë të veçimit fizik të informatës, me përpunim teknik të dokumentit me qëllim mbrojtjen e informatave që nuk mund të zbulohen, apo diçka të ngjashme).

Informata për operatione të thesarit, janë pjesë e posaçme e Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik, të përcaktuara në nenin 7. Poseduesi i informatave i cili disponon të dhëna në lidhje me pagesa përmes organit të administratës shtetërore përgjegjës për operationet e thesarit, është i detyruar ta informojë publikun për të dhënat nëpërmjet faqes së saj të internetit.

Në bazë të nenit 8 të ligjit, secili posedues i informatave për ndërmjetësim cakton një apo më shumë persona zyrtarë kur ushtron të drejtën për qasje të lirë në informata. Poseduesit të informatave janë të detyruar të sigurojnë informojnë publikun për personin zyrtarë për ndërmjetësimin me informata. Personi zyrtarë për ndërmjetësim me informata kontakton dhe siguron informatat e nevojshme dhe i ndihmon kërkuesit të informatave, për çka mban evidencë të veçantë për pranimin e kërkesave për informata, ruajtjen dhe dhënien e informatave.

Për të siguruar transparencë në punën dhe me qëllim njoftimin e publikut më të gjerë, neni 10 parashikon rregull për informimin e publikut të gjerë. Në bazë të këtij neni të ligjit, informimi i publikut të gjerë bëhet përmes faqes së internetit të poseduesit të informatës, në të cilën publikohen të dhënat e detyrueshme të përcaktuar në këtë nen të ligjit. Kjo dispozitë e ligjit i përfshin të dhënat në vijim: të dhënat e kompetencave që ai kryen, përkatësisht i janë

përcaktuar me ligj; të dhënat themelore për kontakt me poseduesin e informatës edhe atë: emrit, adresës, numrit të telefonit, numrit të faksit, adresën e postës elektronike dhe adresën e faqes së internetit; të dhënat për personin zyrtar ose përgjegjës tek poseduesi i informatës (biografi, detajet e kontakti, etj.); të dhënat themelore për kontakt me personin zyrtar për ndërmjetësim me informata, edhe atë: emri dhe mbiemri, postën elektronike dhe numrin e telefonit; të dhënat themelore për kontakt me personin e autorizuar për paraqitje të brendshme të mbrojtur, edhe atë: emrin, mbiemrin, postën elektronike dhe numri i telefonit; listë të personave të punësuar te poseduesi i informatës dhe pozitat e tyre, postën elektronike zyrtare dhe numrin e telefonit zyrtarë; ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencën e poseduesit të informatave në lidhje me regjistrin e rregullave të publikuara në gazetën zyrtare; rregullat që në kuadër të kompetencave të veta i miraton poseduesi i informatës në formë të aktit nënligjor: rregulloreve (rregullore për organizim të brendshëm, rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, rregullore për paraqitje të brendshme të mbrojtur, etj.), dekrete, urdhra, udhëzime, plane, programe, aktvendime dhe lloje të tjera të akteve për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera, kur për këtë janë të autorizuar me ligj; grafiku i organizimit të brendshëm; planet strategjike dhe strategjitë për punë të poseduesve të informatës; planet dhe programet vjetore të punës; buxheti vjetor dhe llogarisë përfundimtare; planeve vjetore financiare sipas tremujorëve dhe programet për realizimin e buxhetit; raporte auditimi, llojet e shërbimeve të cilat i ofrojnë poseduesit e informatave (informata mbi qasjen fizike për realizimin e shërbimeve dhe informatave për shërbimet elektronike, të dhënat për bazat ligjore, emrin e shërbimeve, dokumentet dhe të dhënat për realizimin e çdo shërbimi, mekanizmat për mbrojtje juridike dhe të dhëna tjera përkatëse); tarifat për kompensimet për lëshimin e akteve reale; mënyrën e parashtrimit të kërkesës për qasje në informata (mënyra e parashtrimit të kërkesës me gojë dhe me shkrim për qasje në informata, si dhe

kërkesë e parashtruar në formë elektronike); dokumentacion të plotë për prokurimet publike për koncesionet dhe për marrëveshjet për partneritet privatë-publik; propozim – programe, programe, qëndrime, mendime, studime dhe dokumente tjera të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me aktet nga kompetenca e poseduesit të informatave, njoftime para publikut për çështje të ndërmarra nga faqja e internetit të tyre në pajtim me kompetencat ligjore; buletine informative, fletë zyrtare nëse janë obligim në pajtim me ligj dhe të tjera; raporte mbi punën që ata i paraqesin të organet kompetente për zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes; të dhëna statistikore mbi punën, si dhe informata të tjera, si dhe akte dhe masa me të cilat ndikohet mbi jetën dhe punën e qytetarëve dhe të cilat rrjedhin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatave dhe informata të tjera të cilat rrjedhin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatave.

Bëhet fjalë për një listë të gjerë të dokumenteve që përfshijnë të dhëna financiare, të dhëna për organizimin e poseduesit të informatës, të dhëna për të punësuarit, etj. Pjesa më e madhe e këtyre informatave mund të jenë me interes për individë dhe persona juridikë të kërkuara përmes kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik, dhe nëse këto informata janë të publikuara paraprakisht në faqen e internetit të poseduesit, kërkuar i informatës, informatat do ti sigurojë më shpejtë, më lehtë dhe në mënyrë më të thjeshtë. Njëkohësisht, poseduesi i informatës, nuk do të ketë nevojë të shpenzon resurse plotësuese për të vepruar në bazë të kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik.

Personat përgjegjës të poseduesit të informatave për të siguruar qasje të lirë në informata janë të detyruar që të sigurojnë hapësira për kërkuar të kenë qasje në informatat e kërkuara, ndërsa personat zyrtarë për ndërmjetësim me informata janë të detyruar t'u ofrojnë ndihmë gjatë kërimit të informatave në pajtim me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër.

Neni 12 i Ligjit, parashikon që kërkuesi qasjen në informata mund ta kërkojë me gojë, me shkrim ose me shkresë elektronike. Për më tepër, kërkuesi është i detyruar të prononcohet për mënyrën e mëtutjeshëm të komunikimit me poseduesin e informatës edhe atë me gojë, në formë të shkruar ose në formë elektronike. Çdo kërkues në bazë të kërkesës ka të drejtë për qasje në informata të poseduesit të informatës, të cilat poseduesi i disponon, edhe atë me vëzhgim, kopje, fotokopje ose shkresë elektronike.

Në raste kur kërkuesi i informatës kërkon qasje në informatë me kërkesë me gojë, në bazë të nenit 13 të ligjit, poseduesi i informatës është i detyruar kërkuesit t'i sigurojë qasje te informata, në atë mënyrë që kërkuesi të ketë kohë të mjaftueshme që të njihet me përmbajtjen e saj, me çka poseduesi i informatës përpilon procesverbal, përveç nëse bëhet fjalë për informatë nga neni 6 paragrafi (1) të ligjit.

Nëse poseduesi i informatës përgjigjet pozitivisht kërkesës, menjëherë ndërsa më së voni në afat prej pesë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, t'i mundëson njohje me përmbajtjen informatës së kërkuar në mënyrë që mundëson qasjen për shikimin e informatës, i siguron kopje, fotokopje, ose shkresë elektronike nga informata e kërkuar.

Përndryshe, nëse poseduesi i informatës përgjigjet negativisht mbi kërkesën ose nuk mund t'i përgjigjet menjëherë kërkesës, si dhe nëse kërkuesi ka kundërshtime verbale ose me shkrim për mënyrën e paraqitjes së informatës, personi zyrtarë për ndërmjetësim me informata është i detyruar për kërkesën të përpilojë një aktvendim në të cilin do të vendosë të dhënat për kërkuesin, datën e pranimin të kërkesës dhe të njoftojë për kërkesën e veçantë, përkatësisht për informatën e kërkuar.

Në bazë të nenit 14 të ligjit, për kërkesë me shkrim për qasje në informata vendos poseduesi i informatave në procedurë të caktuar me këtë ligj. Kërkesa e

cila është parashtruar në mënyrë elektronike në bazë të nenit 15 të ligjit, konsiderohet si kërkesë me shkrim.

Neni 16 i ligjit parashikon formën dhe përmbajtjen e kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik. Në bazë të nenit 16, formën e formularit të kërkesës për qasje të lirë në informata e përcakton drejtori i Agjencisë dhe poseduesi i informatës është i detyruar t'ia sigurojë formularin kërkuesit. Në bazë të nenit 16 paragrafi (2) të ligjit, kërkesa parashtrohet në formularë ose në formë tjetër dhe në mënyrë në pajtim me neni 12 paragrafin (1) të ligjit.

Ligji gjithashtu parashikon edhe përmbajtjen e kërkesës. Kështu, neni 16 parashikon se kërkesa të përmbajë emrin e poseduesit të informatës, emrin personal dhe mbiemrin e kërkuesit të informatës, të dhëna për përfaqësuesin e mundshëm ose personin e autorizuar, shoqërinë ose personin juridik. Gjithashtu, në kërkesë, kërkuesi është i detyruar të tregojë informatën me të cilën dëshiron të njihet dhe në çfarë mënyre do të njihet me përmbajtjen e informatës së kërkua (vëzhgim, përshkrim, fotokopje, shkresë elektronike).

Kërkuesi nuk është i detyruar ta arsyetojë kërkesën për qasje në informata, por nevojitet të theksojë se bëhet fjalë për kërkesë për qasje në informata.

Në këtë pjesë të ligjit, duhet të specifikohet se poseduesi i informatës duhet të veprojë sipas kërkesës, edhe nëse kërkesa nuk paraqitet në formën e formularit të përcaktuar. Kërkesa mund të paraqitet në çdo formë, me kusht që ti përmbajë të gjitha elementet të përcaktuara me ligj. Kjo veçanërisht shihet në dispozitat e nenit 17 të ligjit, të cilat parashikojnë procedura për plotësimin e kërkesës e cila nuk është e plotë dhe gjithashtu parashikojnë detyrim për personin e autorizuar për ndërmjetësim për ti siguruar kërkuesit ndihmën e nevojshme për përpilimin e kërkesës. Për këtë arsye, forma, gjegjësisht formulari i kërkesës nuk mund të konsiderohet si kusht për përpunimin e kërkesës. Zyrtari i caktuar për ndërmjetësimin me informata është i detyruar t'ia sigurojë ndihmën e nevojshme kërkuesit të informatës gjatë plotësimit të kërkesës.

Nëse sipas lëndës së kërkesës është e qartë se bëhet fjalë për kërkesë për qasje në informata në pajtim me këtë ligj, poseduesi i informatës detyrimisht e shqyrton kërkesën në pajtim me këtë ligj.

Në praktikë, mund të ndodhë situatë ku kërkuesi i informatës për shkak të mosdijes kërkesën e ka dorëzuar te ndonjë subjekt i cili nuk posedon këtë informatë. Në këtë situatë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) të ligjit, nëse poseduesi i informatave që e ka pranuar kërkesën nuk posedon me informatat e kërkuara, është i detyruar që menjëherë ose më së voni në afat prej tri ditësh të ridërgojë kërkesën te poseduesi i informatës i cili sipas përmbajtjes së kërkesës është posedues i informatës dhe për këtë të njoftojë kërkuesin.

Kjo është shumë e rëndësishme, dhe ka për qëllim të inicion transparencë dhe llogaridhënie të institucioneve. Gjithashtu, është e mundur që kërkuesi i informatës të anashkalojë se kush e posedon informatën, në situata ku një person juridik është i themeluar nga tjetër person juridik, kështu që do të ishte e paarsyeshme të kërkohej nga kërkuesi të dorëzon kërkesë të re. Do të ishte më praktike dhe më e qartë, institucioni që ka pranuar kërkesën ta dërgon atë te poseduesi i vërtetë (për shembull, kërkesa ka të bëjë me informata të natyrës arsimore, por në vend të shkollës së mesme të themeluar nga komuna, kërkesa është dërguar deri te komuna si themelues. Në këtë rast komuna duhet ta ridërgon kërkesën te shkolla e mesme). Afati për marrje të informatës fillon të rrjedhë nga dita e pranimit të kërkesës nga poseduesi i informatës të cilit i është ridërguar kërkesa.

Procedurën për kërkesën për qasje të lirë në informata te poseduesi i informatës e zbaton personi zyrtar i autorizuar për këtë. Nëse poseduesi i informatave përgjigjet pozitivisht kërkesës ose nëse kërkesën pjesërisht ose tërësisht e refuzon, për këtë do të sjellë vendim. Vendimi, me të cilin kërkesa tërësisht ose plotësisht është refuzuar domosdoshmërisht duhet të përmbajë

arsyetim për shkaqet për të cilat kërkesa është refuzuar dhe për rezultatet nga testi i realizuar i dëmshmërisë.

Në raste kur poseduesi i informatës nuk përgjigjet në afatin e caktuar në nenin 21 të ligjit, ose nuk i siguron kërkuesit qasje në informata, dhe nëse nuk miraton dhe nuk i dorëzon kërkuesit vendim, konsiderohet se kërkesa është refuzuar, me ç' rast kërkuesi mund të parashtrojë ankesë deri te Agjencia në afat prej 15 ditësh.

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik, poseduesi i informatës është i detyruar t'i përgjigjet menjëherë kërkesës së kërkuesit dhe jo më vonë se 20 ditë nga dita e pranimi të kërkesës. Poseduesi i informatës, informatën e jep në formën e kërkuar, përveç nëse informata e kërkuar tashmë ekziston në një formë të caktuar dhe është në dispozicion për publikun dhe nëse është më e përshtatshme për kërkuesin informata të dorëzohet në formë ndryshe nga ajo e që është kërkuar, për të cilën poseduesi i informatës është i detyruar të arsyeton shkakun për mënyrën e tillë të dorëzimit.

Në situata të caktuara, mund të vazhdohet afati i parashikuar në nenin 21. Përkatesisht, në bazë të nenit 22 të ligjit, në rast kur poseduesi i informatës duhet të mundësojë qasje të pjesshme në informata në pajtim me nenin 6 paragrafi (4) të këtij ligji ose për shkak të vëllimit të informatës së kërkuar, nevojitet kohë më e gatë nga afati i caktuar në nenin 21 të këtij ligji, afati mund të vazhdohet më së shumti deri në 30 ditë nga dita e pranimi të kërkesës. Poseduesi i informatës për vazhdimin e afatit është i detyruar ta njoftojë në formë elektronike kërkuesin menjëherë, ose më së voni shtatë ditë nga dita e pranimi të kërkesës. Nëse poseduesi i informatës nuk vepron në afatin e caktuar, kërkuesi i informatës mund të parashtrojë ankesë te Agjencia.

Në bazë të nenin 21 paragrafi (1) të ligjit, nëse poseduesi i informatës i përgjigjet pozitivisht kërkesës, i mundëson kërkuesit menjëherë të njihet me përmbajtjen e informatës së kërkuar, edhe atë me vëzhgim, përkshkrim, fotokopje ose shkresë elektronike. Nëse kërkuesi kërkon t'i mundësohet vëzhgim në

informata, poseduesi i informatës është i detyruar t'i mundësojë qasje në atë mënyrë që kërkuesi të ketë kohë të mjaftueshme të njihet me përmbajtjen e saj. Nëse, si rezultat i informatës së marrë, lind kërkesë për informatë plotësuese në lidhje me dokumentet të cilat i posedon poseduesi i informatës, kërkuesi i informatës parashtron kërkesë të re në bazë të neneve 15 dhe 16 të këtij ligji, së bashku me përgjigjën që tashmë e ka marrë.

Nëse kërkuesi konsideron se informata me të cilën ai është njohur nuk është informata të cilën e ka theksuar në kërkesë, mund të kërkojë nga poseduesi i informatës t'i mundësojë të njihet me informatën që e ka theksuar në kërkesë brenda dhjetë ditëve pas pranimit të kërkesës së serishme të poseduesit i informatës. Nëse poseduesi i informatës nuk i përgjigjet kërkuesit të informatës për kërkesën e serishme, pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, kërkuesi i informatës mund të parashtrojë ankesë në Agjenci në afat prej 15 ditësh.

Në bazë të nenit 25 të ligjit, poseduesi i informatës me vendim mundet që tërësisht ose pjesërisht ta refuzojë kërkesën, nëse konstaton se informata e kërkuar është informatë nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji, duke e marrë parasysh rezultatin nga testi i realizuar i dëmshmërisë.

Në bazë të nenit 27 të ligjit, kundër vendimit të poseduesit të informatës për refuzimin ose anulimin e kërkesës, kërkuesi ka të drejtë anekse në Agjenci në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Agjencia vendos për ankesën e kërkuesit në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës. Nëse Agjencia në afat prej 15 ditësh nuk sjell vendim për ankesën e kërkuesit kundër vendimit të shkallës së parë, dhe nuk e sjell atë edhe në afat prej shtatë ditëve pas kërkesës së serishme, kërkuesi mund të ngrejë kontest administrativ. Poseduesi i informatës është i detyruar ta zbatojë vendimin e Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij dhe për të njëjtën ta njoftojë Agjencinë.

Në drejtim të sigurimit të transparencës dhe përgjegjësisë, dispozitat e nenit 28 të ligjit që rregullojnë shpenzimet për sigurimin e informatës, janë veçanërisht të rëndësishme. Në bazë të nenit 28 paragrafi (1) të ligjit, vëzhgimi në informatën e kërkuar është falas. Kërkuesi i informatës për përshkrimin e marrë, fotokopjen ose shkresën elektronike të informatës, paguan kompensim në lartësi të shpenzimeve materiale. Nëse kërkesa ka të bëjë me informatë me vëllim më të madh, poseduesi i informatës mund të kërkojë kërkuesi të paguajë paraprakisht kompensimin për mbulimin e shpenzimeve për marrjen e informatës.

Një risi e veçantë e futur në ligjin e vitit 2019 është themelimi i Agjencisë për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë në informata me karakter publik, e cila ka zëvendësuar Komisionin aktual. Në bazë të nenit 29 të ligjit, Agjencia për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë në informata është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur, i cili punon dhe sjell vendime në pajtim me kompetencat e caktuara me ligj. Mjetet për punën e Agjencisë sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë Veriore. Selia e Agjencisë është në Shkup.

Në nenit 30 të ligjit janë të rregulluara kompetencat e Agjencisë. Në bazë të nenit 31 të ligjit, me Agjencinë udhëheq drejtor.

Një nga mekanizmat e kontrollit, të parashikuara në ligji është edhe detyrimi për hartimin e raportit vjetor, i theksuar në nenit 36 të ligjit. Përkatësisht, në bazë të nenit 36 të ligjit, personi zyrtar të poseduesi i informatave është i detyruar të përgatisë raport vjetorë për zbatimin e këtij ligji, t'ia dorëzojë Agjencisë deri më 31 janar të vitit aktual për vitin e kaluar dhe ta publikojë atë në faqen e internetit të poseduesit të informatave me karakter publik.

Në interes të veçantë është edhe neni 37 i ligjit. Përkatësisht, në bazë të kësaj dispozite, lirohet nga përgjegësia i punësuar i poseduesi i informatave i cili do të japë informatë të mbrojtur, nëse kjo informatë është me rëndësi për zbulimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe sjelljen korruptive, si dhe për

parandalimin e kërcënimeve serioze për shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe rrezikimin e mjedisit jetësor.

Ligji për qasjen e lirë në informata me karakter publik parashikon edhe dispozita kundërvajtëse. Për këtë qëllim, si dispozitë kundërvajtëse është paraparë shkelje e bërë nga një funksionar ose menaxher të poseduesi i informatës nëse nuk ka caktuar person zyrtarë për ndërmjetësimin e informatave në ushtrimin e drejtës për qasje të lirë në informata dhe nuk siguruar informimin e publikut për personin zyrtar në bazë të nenit 8 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji. Ligji, gjithashtu parashikon kundërvajtje për personin zyrtarë, edhe atë nëse vepron në kundërshtim me nenin 6 paragrafi (3) të ligjit, më tutje, nëse nuk e mirëmban dhe përditëson listën e informatave me të cilat disponon dhe nuk e publikon atë në mënyrë të përshtatshme, në dispozicion të kërkuesit, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji, më tutje, nuk ofron ndihmë në kërkimin e informatave në pajtim me nenin 11 të këtij ligji, më tutje, nëse kërkon arsyetim nga kërkuesi i informatës në kundërshtim me nenin 16 paragrafi (5) të ligjit, më tutje, nëse në afatin e paraparë prej 20 ditësh, përkatësisht 30 ditësh, pa pasur bazë nuk mundëson qasje në informata në pajtim me nenet 21 dhe 22 të këtij ligji, si dhe nuk mban evidencë në pajtim me nenet 8 paragrafi (3) dhe (36) paragrafi (2) të këtij ligji, përkatësisht detyron të paguajnë kërkuesit për qasje në informatën e kërkuar në kundërshtim me nenin 10 paragrafi (3) të këtij ligji, ose nuk e zbaton vendimin e Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i tij në pajtim me nenin 27 paragrafi (4) të këtij ligji, dhe në fund nuk do ta përgatisë raportin vjetor për zbatimin e këtij ligji dhe nuk do ta dorëzojë në Agjenci, në bazë të nenit 36 të këtij ligji.

Në bazë të nenit 40 të ligjit, për kundërvajtjet e caktuara me këtë ligj, Komisioni i Kundërvajtjes në Agjenci, udhëheq procedurën për kundërvajtje si dhe i shqipton sanksionet. Anëtarët e Komisionit për Kundërvajtje janë të punësuar në Agjenci me shkallën dhe llojin e duhur të përgatitjes profesionale

dhe përvojën e nevojshme të punës të përcaktuar me ligj, prej të cilëve së paku njëri nga anëtarët është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës. Para paraqitjes së kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, mbahet një procedurë të shlyerjes me lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Rekomandime dhe gjetje:

Me qëllim përmirësimit të zbatimit të këtij ligji, si duket nevojitet që:

- Të mundësohet në mënyrë elektronike të parashtrohet kërkesë për qasje të lirë në informata me karakter publik, përmes një formulari të posaçëm elektronik në faqen e internetit të poseduesit të informatave me karakter publik.
- Sigurimi i një shume të caktuar nga buxheti shtetëror, me të cilin do të mbulohen shpenzimet eventuale, për dokumentet të cilat do të kërkohen nga poseduesi i informatës, në bazë të nenit 28 të ligjit. Kjo masë do të ishte veçanërisht e zbatueshme kur si kërkues të informatës do të paraqiten organizata joqeveritare dhe aktivistë qytetarë.
- Parashikimi i dispozitave të posaçme kundërvajtëse edhe për funksionar dhe menaxherë në situatë kur pa bazë do të refuzohet veprimin sipas kërkesës për qasje të lirë në informata, duke ndjekur shembullin e ligjit të mëparshëm (neni 39 i ligjit të mëparshëm për qasje të lirë në informata me karakter publik).